

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7999
E martë, 25. shkurt 2025
Çmimi 0.50 €

Cili/cila do të jetë Juda
Iskarioti për formimin e
qeverisë? | FAQE 6



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DËSHMITARI ISMET TARA, NË HAGË, AKUZA TË RËNDA NDAJ GJYKATËS SPECIALE

KOMANDANT 'HOXHA': NUK I BESOJ SPECIALES. JENI TË KORRUPTUAR!

| FAQE 4-5

Ismet Tara është paraqitur të hënën para Gjykatës Speciale në cilësinë e dëshmitarit në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Tara, i njohur si komandant "Hoxha", ka refuzuar të përgjigjet në pyetjet e ZPS-së pasi ka kërkuar ta publikojë një dokument për të cilin ka thënë se ia ka rrezikuar jetën atij edhe familjes së tij. Pavarësisht prej përpjekje të kryetarit të trupit gjyqësor, Tara ka refuzuar të përgjigjet, duke e quajtur të korruptuar Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se edhe po ta vrasin nuk do të japë asnjë përgjigje pa ia paraqitur dokumentin e vitit 2019, i cili, sipas tij, është ndryshuar nga hetuesit e Speciales, të cilët i ka quajtur kriminelë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nuk i beson Speciales. Pas ndërprerjes të disahershme të seancës dhe refuzimit të Tarës që të përgjigjet, ZPS-ja ka hequr dorë që ta marrë në pyetje komandant "Hoxhën"



**KUSH ËSHTË
FRIEDRICH
MERZ, NJERIU
QË PRITET
TË BËHET
KANCELAR I
GJERMANISË?** | F. 2



**KOSOVA
DHE MASAT
E BE-së: NJË
NGËRÇ ME
PASOJA TË
ZGJATURA** | F. 4



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**VDIQ FRANK WISNER, DIPLOMATI
AMERIKAN QË SHËRBEU I DËRGUAR
SPECIAL I SHBA-SË NË BISEDIMET
PËR STATUSIN E KOSOVËS** | F. 5

**ZELENSKY LAVDËRON
HEROIZMIN E UKRAINASVE
TREVJETORIN E LUFTËS** | F. 2

**TË MËRKURËN NIS NUMËRIMI
I VOTAVE TË DIASPORËS, TË
PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA DHE ATYRE ME KUSHT** | F. 7

**INVESTIMET E BEI-t SHËNUAN
NJË VLERË PREJ 693 MILIONË
EUROSH NË BALLKANIN
PERËNDIMOR NË 2024** | F. 5

EKONOMI



**BIE NUMRI I PËRFITUESVE NGA
NDIHMA SOCIALE** | F. 8

**BRENDA DY JAVËSH HAPET
THIRRJA PËR SUBVENCIONIM
TË FERMERËVE** | F. 8

SPORT

**GJYQTARI BEJTULLAHU: BËRA DY
GABIME TË RËNDA, VAR-I NUK
THIRRI PËR RISHIKIM** | F. 10

Kush është Friedrich Merz, njeriu që pritet të bëhet kancelar i Gjermanisë?

BERLIN, 24 SHKURT - Friedrich Merz, i cili është në rrugë për t'u bërë kancelari i 10 i Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore, pas zgjedhjeve kombëtare, ka thënë se do ta bëjë prioritet unitetin evropian dhe sigurinë e kontinentit, ndërkohë që përballat me administratën e re Trump dhe luftën e Rusisë në Ukrainë.

Merz tha të hënën se blloku i tij konservator kishte fituar një numër të mjaftueshëm ulësesh në zgjedhjet kombëtare për të ndërtuar një koalicion me Socialdemokratët e qendrës së majtë (SPD), të kancelarit në largim, Olaf Scholz.

Ai shtoi se bisedat do të fillonin në ditët e ardhshme dhe do të zgjasnin disa javë.

Çështjet kryesore do të ishin marrëdhëniet e jashtme, migrimi dhe ekonomia, tha ai. Merz ka thënë se nuk do të punojë me partinë anti-imigracion të së djathtës ekstreme AfD (Alternativa për Gjermaninë), pavarësisht se kjo parti përfundoi e dyta.

Lideri konservator 69-vjeçar i fitoi zgjedhjet kombëtare të Gjermanisë me 28.5 për qind të votave. "Unë jam gjithashtu i vetëdijshëm për shkallën e detyrës që tani na pret", u tha ai mbështetësve pas fitores së tij të dielën natën. "Bota jashtë nuk na pret, dhe nuk po pret për biseda dhe negociata të zgjatura koalicioni".

Merz, avokat me profesion, pa rënien e karrierës së tij për shkak të ish-kancelares Angela Merkel në fillimet e viteve 2000 dhe madje e la politikën për disa vjet. Pavarësisht përvojës së tij politike, ai nuk ka shërbyer më parë në qeveri.

Rivaliteti me Merkelin

Merkeli e ka përshkruar Merzin si një folës brilant dhe ka lavdëruar dëshirën e tij për udhëheqje, megjithëse ajo e ka pranuar se ky ishte një problem në marrëdhënien e tyre. "Jemi pothuajse të një moshe... U rritëm krejtësisht ndryshe, gjë që ishte më tepër një mundësi se një pengesë", shkroi ajo në librin e saj "Liria" (Freedom). "Por, kishte një problem, që nga fillimi: Të dytë donim të ishim shef", tha



ajo. Merkel u përpoq të konsolidojë kontrollin e saj në qendrën e djathtë të Gjermanisë, pasi Unioni humbi ngushtë në zgjedhjet kombëtare më 2002. Ajo e largoi Merzin nga pozita e udhëheqësit e grupit të saj parlamentar, duke marrë vetë këtë detyrë, përveç asaj të udhëheqjes së partisë Bashkimi Demokratik Kristian që e kishte. Ajo vazhdoi të udhëheqë Gjermaninë nga 2005 deri në 2021.

Largimi nga politika

Merzi nuk u mor aktivisht me politikë për disa vjet pasi u largua nga Parlamenti më 2009. Ai u mor me avokaturën dhe drejtoi bordin mbikëqyrës të degës gjermane të menaxherit të investimeve BlackRock. Gjatë kësaj periudhe, ai shpesh udhëtonte për biznes në Shtetet e Bashkuara dhe Kinë, megjithëse nuk ka jetuar kurrë jashtë Gjermanisë. "Friedrich Merz ndoshta është kancelari më ndërkombëtar që ka pasur Gjermania që nga lufta - nëse bëhet kancelar", tha Volker Resing, i cili shkroi biografinë e sapo botuar "Friedrich Merz: Rrugë e tij drejt pushtetit". Merz "mbështetet në iniciativën personale, në lirinë e individit, në krijimtari dhe motivim. Dhe

vetëm më pas në shtet", tha Resing.

Rikthimi politik

Merzi nisi rikthimin e tij politik pasi Merkel dha dorëheqje si udhëheqëse e CDU-së më 2018 dhe njoftoi se nuk do ta kërkonte mandatin e pestë si kancelar. Megjithatë, ai u mposht ngushtë nga kandidatët qendrorë më 2018 dhe fillimet e 2021-shit.

Merzi vazhdoi dhe u zgjodh si udhëheqës i partisë në përpjekjen e tretë, pa humbjes së qendrës së djathtë nga kancelari aktual, Olaf Scholz, në zgjedhjet e Gjermanisë më 2021. Ai e forcoi pushtetin e tij duke u bërë gjithashtu udhëheqësi i Grupit Parlamentar të Unionit.

Sipas Resing, "mënyra e Merzit për të bërë politikë" nuk është t'i shmangë përballjet me çdo çmim. Në vend të kësaj, ai mban një perspektivë se "një sasi e caktuar provokimi mund të nisë një debat të vërtetë dhe ndoshta një zhvillim të vërtetë në lëvizje". Gjatë fushatës zgjedhore, Merzi ka premtuar të forcojë sërish ekonominë e Gjermanisë dhe të kufizojë migracionin e parregullt. Me presidentin Donald Trump të rikthyer në Shtëpinë e Bardhë dhe tensionet në rritje mbi mënyrën për të zgjidhur luftën në Ukrainë, Merz, i cili e ka mbështetur prej

kohësh një marrëdhënie të fortë transatlantike, tha pas fitores së tij se prioriteti i tij kryesor është ta bashkojë Evropën përballë sfidave që vijnë nga Shtetet e Bashkuara dhe Rusia. "Nuk kam asnjë iluzion për atë që po ndodh në Amerikë", u tha ai mbështetësve. "Ne jemi nën një presion kaq të madh... prioriteti im absolut tani është me të vërtetë të krijoj unitet në Evropë".

A po flirtonte me të djathtët ekstreme?

Merzi vendosi për forcimin e ligjeve të emigracionit të Gjermanisë në krye të fushatës zgjedhore pasi një migrant vrau dy persona në një sulm me thikë në qytetin bavarez Aschaffenburg muajin e kaluar. Ai solli para Parlamentit një propozim jobligues, duke kërkuar që migrantët të kthehen mbrapa nga kufijtë e Gjermanisë. Propozimi u miratua ngushtë falë votave nga e djathta ekstreme, AfD. Kjo bëri që kundërshtarët e tij ta akuzonin Merzin se kishte shkelur një tabu duke supozuar se ka punuar me AfD-në, gjë që çoi në një denoncim publik nga Merkel.

Kritikuesit treguan këtë episod si një ilustrim të asaj që thonë se Merz ka tendencë për impulsivitet. Që atëherë qindra mijëra njerëz kanë dalë në rrugë për të protestuar kundër propozimit të Merzit, si dhe kundër ngritjes së të djathtëve ekstreme.

Merz ka insistuar se nuk ka bërë asgjë të gabuar dhe se kurrë nuk ka punuar me AfD-në, dhe gjithashtu ka përsëritur se "kurrë" nuk do të bashkëpunojë me këtë parti nëse bëhet kancelar.

Rrënjët në Gjermaninë rurale

Merzi përfaqëson rajonin e tij rural në Parlamentin e Gjermanisë - një zonë ku njerëzit janë "me këmbë në tokë, ndoshta pak të rezervuar", tha Resing. "Kjo është ajo që e ka formuar: jeta rurale". Si politikan, Merz gjithmonë ka mbrojtur vlerat konservatore dhe ka theksuar rëndësinë e familjes. Ai e takoi bashkëshorten e tij, Charlotte, e cila tani është gjykatëse, ndërkohë që ai studioonte drejtësinë. Çifti ka tre fëmijë të rritur. Merz iu

bashkuar CDU-së në vitin 1972 dhe u zgjodh në Parlamentin Evropian në vitin 1989. Ai hyri për herë të parë në Parlamentin gjerman në vitin 1994.

Në karrigen e pilotit

Si një pilot i pasionuar për hobin e tij, Merz ndonjëherë piloton avionin e tij të vogël nga shtëpia në rajonin Sauerland në Gjermaninë perëndimore drejt Berlinit, herët në mëngjeset e së hënës. Ai ka vazhduar të fluturojë, pavarësisht orëve të gjata që i imponohen nga puna e tij si udhëheqës i opozitës dhe kritika herë pas here se ka një hobi të një njeriu të pasur. "Kur flisni me të për fluturimin, sytë e tij shkëlqejnë", tha Resing. "Ai thotë se kur je mbi re, ajo është liria".

Zelensky lavdëron heroizmin e ukrainasve

Kiev, 24 shkurt - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se është krenar për vendin e tij, për "tre vjet të rezistencës" dhe për "tre vjet të heroizmit absolut të ukrainasve". Zelensky e lëshoi këtë deklaratë në ditën kur bëhen tre vjet prej se Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, më 24 shkurt 2022. "Faleminderit për të gjithë ata që e mbrojnë dhe e ndihmojnë Ukrainën! Për të gjithë ata që punojnë për Ukrainën! Dhe, qoftë i përjetshëm kujtimi për të gjithë ata që dhanë jetën e tyre për shtetin dhe popullin tonë!", tha Zelensky.

Për të shënuar këtë ditë, ai thirri një samit ndërkombëtar të sigurisë në Kiev.

Duke iu drejtuar pjesëmarrësve, që përfshijnë udhëheqësit e Bashkimit Evropian dhe kryeministrin e Kanadasë, Justin Trudeau, Zelensky bëri thirrje për një shkëmbim masiv të të burgosurve me Rusinë. Një gjë e tillë, tha ai, do të mund të shërbente si "masë besimi" mes dy vendeve. Por, ai shprehu dyshime në lidhje me perspektivat e bisedimeve për paqe me Rusinë. "[Presidenti rus, Vladimir] Putin nuk do të na dhurojë paqen. Ai nuk do ta shkëmbejë atë me diçka. Ne duhet ta arrijmë paqen përmes forcës, mençurisë dhe unitetit", tha Zelensky.

Zelensky lavdëron heroizmin e ukrainasve në tri vjet luftë

Kiev, 24 shkurt- Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se është krenar për vendin e tij, për "tre vjet të rezistencës" dhe për "tre vjet të heroizmit absolut të ukrainasve". Zelensky e lëshoi këtë deklaratë në ditën kur bëhen tre vjet prej se Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, më 24 shkurt, 2022. "Faleminderit për të gjithë ata që e mbrojnë dhe e ndihmojnë Ukrainën. Për të gjithë ata që punojnë

për Ukrainën. Dhe, qoftë i përjetshëm kujtimi për të gjithë ata që dhanë jetën e tyre për shtetin dhe popullin tonë", tha Zelensky.

Për të shënuar këtë ditë, ai thirri një samit ndërkombëtar të sigurisë në Kiev.

Duke iu drejtuar pjesëmarrësve, që përfshijnë udhëheqësit e Bashkimit Evropian dhe kryeministrin e Kanadasë, Justin Trudeau, Zelensky bëri thirrje për një shkëmbim masiv të të

burgosurve me Rusinë. Një gjë e tillë, tha ai, do të mund të shërbente si "masë besimi" mes dy vendeve.

Por, ai shprehu gjithashtu dyshime në lidhje me perspektivat e bisedimeve për paqe me Rusinë. "[Presidenti rus, Vladimir] Putin nuk do të na dhurojë paqen. Ai nuk do ta shkëmbejë atë me diçka. Ne duhet ta arrijmë paqen përmes forcës, mençurisë dhe unitetit", tha Zelensky.



DËSHMITARI ISMET TARA, NË HAGË, AKUZA TË RËNDA NDAJ GJYKATËS SPECIALE

KOMANDANT 'HOXHA': NUK I BESOJ SPECIALES. JENI TË KORRUPTUAR!

Ismet Tara është paraqitur të hënën para Gjykatës Speciale në cilësinë e dëshmitarit në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Tara, i njohur si komandant "Hoxha", ka refuzuar të përgjigjet në pyetjet e ZPS-së pasi ka kërkuar ta publikojë një dokument për të cilin ka thënë se ia ka rrezikuar jetën atij edhe familjes së tij. Pavarësisht prej përpjekje të kryetarit të trupit gjykues, Tara ka refuzuar të përgjigjet, duke e quajtur të korruptuar Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se edhe po ta vrasin nuk do të japë asnjë përgjigje pa ia paraqitur dokumentin e vitit 2019, i cili, sipas tij, është ndryshuar nga hetuesit e Speciales, të cilët i ka quajtur kriminelë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nuk i beson Speciales. Pas ndërprerjes të disahershme të seancës dhe refuzimit të Tarës që të përgjigjet, ZPS-ja ka hequr dorë që ta marrë në pyetje komandant "Hoxhën"

EPOKA
ERE

Lirim GECI

HAGË, 24 SHKURT - Ismet Tara, i njohur si komandant "Hoxha", është paraqitur të hënën në cilësinë e dëshmitarit në rastin e liderëve të UÇK-së në Hagë, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Paraqitja e tij para Gjykatës Speciale është përcjellë me tensione, ku komandant Hoxha ua ka bërë të qartë prokurorëve dhe gjykatësve se nuk do të përgjigjet në asnjë pyetje të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) pa ia paraqitur një dokument të vitit 2019, i cili, sipas tij, ia ka rrezikuar jetën edhe familjarëve të tij. "Dua t'i jap shqetësimet e mia dhe dua të njoftoj ashtu siç e kam njoftuar prokuroren e cila ka ndërhyrë që gjoja unë e kam ndryshuar vetveten gjatë bisedës me prokuroren time gjatë marrjes ose në përpunimin ose përgatitjes sime në seancë. Këtë shqetësim ia kam paraqitur prokuroros sime, por edhe anëtarëve të sigurimit tim fizik. Mos më mundoni. Të kaloj dokumenti dhe unë do t'ju përgjigjem", ka thënë ai. Në këtë kontekst ai ka thënë se nuk i beson Gjykatës Speciale. "Ma keni ndërruar dokumentin. Nuk është ai që kam lexuar. Dokumenti është nënshkruar prej intervistuesve të mi, pa dijeninë time, pa më njoftuar. Nuk i besoj kësaj gjykate. Këtë dokument keni provuar ta ndryshoni. Nuk i besoj asgjë më kësaj gjykate. Nuk flas më asgjë. Më kanë paraqitur si tradhtar të Kosovës. Ky është dokument që kurrë nuk ma keni

paraqitur. Nuk ma keni dhënë as numrin, dhe kam dyshuar se ky dokument është humbur, nëse nuk paraqitet para meje. Nuk jam këtu lojë. Kam bërë luftë çlirimtare për popullin tim. Nuk i frikësohem askujt", ka thënë dëshmitari Tara, duke thënë se ky dokument që është duke e kërkuar është i vitit 2019. "Dokumentin këtu nuk është që e kam lexuar. Dokumenti është nënshkruar prej intervistuesve të mi më 2019-n pa dijeninë time, pa nënshkrimin tim, pa më njoftuar për dokumentin. Keni provuar ju ta ndryshoni. Ky nuk është dokumenti që unë kërkoj. Prej tash nuk i besoj asgjë kësaj gjykate dhe nuk flas asgjë", ka thënë komandant Tara. Pavarësisht prej përpjekje të kryetarit të trupit gjykues që të përgjigjet në pyetjet e ZPS-së, komandant Hoxha ka këmbëngulur në kërkesën e tij. Pasi atij i është paraqitur një dokument tjetër i cili nuk ishte ai që kërkonte dëshmitari, Tara është tensionuar duke thënë se ai nuk është lodër dhe nuk i frikësohet gjyqësisë në Hagë. "Nuk jam unë këtu lojë. Unë kam bërë luftë çlirimtare për popullin tim. Nuk ju frikësohem as juve dhe askujt. Unë kam dëshmuar 32 orë dhe jam në gjendje të dëshmoj prapë 32 orë. Unë i kam edhe CD-të e mia të 2019-s dhe i kam marrë me vete dhe ju ftoj të më lironi dhe t'i sjell CD-të në qoftë se duhet të hetohen të gjitha prej fillimi sepse unë as përkthimit të 2019-s nuk i besoj, por CD-të e mia janë me vete dhe i kam këtu dhe mund t'i sjell që t'i shihni", ka thënë Tara. Dëshmitari Tara ka ngrehur

dyshime se ai dokument me gjasë është "avulluar" brenda gjykatës. "Ma sillni dokumentin, se më duket që ai dokument është avulluar brenda gjykatës. Ai dokument që është lëshuar. Të tregohet se çfarë po bën kjo gjykatë me çlirimtarët, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, me njollosjen e luftës së UÇK-së, pastaj mund të flas", ka thënë Tara, duke shtuar se edhe po të vritet nuk do të flasë pa e parë dokumentin në fjalë. "Edhe po të vritem nuk flas më pa u shfaqur dokumenti në fjalë", ka thënë Tara, duke e quajtur të korruptuar Gjykatën Speciale. "Nuk do të flas pa e paraqitur dokumentin që e kërkoj, z. gjykatës. Mund ta mbyllni seancën menjëherë, por pa m'u paraqitur dokumenti nuk do t'i përgjigjem asnjë pyetjeje sepse dyshimi është që kjo gjykatë është e korruptuar dhe gjykatë që do...", ka thënë Tara, të cilit i është ndërprerë fjala nga gjyqtari. Pasi gjyqtari ia lëshoi sërish mikrofonin, Tara ka thënë se është dyshues te kjo gjykatë dhe tek i tërë stafi i saj. "Unë nuk do të përgjigjem pa m'u paraqitur dokumenti, se unë jam dyshues në tërë gjykatën

dhe në tërë stafin e gjykatës", ka thënë dëshmitari Tara. Më tutje prokurorja e specializuar në Hagë, Vega Iodice është tërhequr nga dëshmia e komandantit të UÇK-së, Ismet Tara, pasi Tara refuzonte të dëshmonte pa iu shfaqur një dokument të cilin e kërkonte në vazhdimësi. "Nuk besoj që dëshmitari do të përgjigjet, andaj kërkoj të pranohen deklaratat e kaluara që i ka dhënë", ka thënë prokurorja. Ndërsa mbrojtja e Veselit dhe e Thaçit kanë theksuar se kjo është shkelje, pasi të akuzuarit nuk kanë mundësi të ballafaqojnë dëshmitarin. Avokati i Kadri Veselit, Rodney Dixon, ka thënë se nuk janë shterur të gjitha mjetet juridike për ta marrë në pyetje dëshmitarin. Ai ka thënë se nuk i është shpjeguar dëshmitarit çështja e mosbindjes ndaj gjykatës dhe se një gjë e tillë ende nuk është konstatuar nga trupi gjykues. Dixon ka thënë se fillimisht, sipas tyre, duhen shteruar të gjitha mjetet e mundshme ligjore që dëshmitari të japë dëshmi para trupit gjykues dhe më pas ata si mbrojtje ta kenë mundësinë t'i bëjnë pyetje dëshmitarit.

Më pas, kryegjyqtari Charles Smith III ka thënë se dëshmitari është paralajmëruar për gjërat që mund të pësojnë nga mosdhënia e dëshmisë, por ai ka theksuar se nuk i bëhet vonë dhe të vazhdojë të mos përgjigjet. Më tutje, Dixon ka thënë e çështja e mosbindjes ndaj gjykatës është një hap që mund të sjellë rezultate, por gjithsesi e ka konsideruar të parakohshme. Ndërsa avokatja e Thaçit, Nina Tavakoli, ka mbështetur Dixonin, duke thënë se trupi gjykues duhet të dalë me konstatim për mosbindje të dëshmitarit ndaj gjykatës. Në rast që nuk bëhet kjo, Tavakoli ka thënë se duan ta dinë në tërësi se çfarë dëshmie po jep ky dëshmitar. Edhe mbrojtja e Krasniqit e përfaqësuar nga avokati Aiden Ellis ka thënë se nuk janë shteruar të gjitha mjetet, duke shtuar se dëshmitarit mund t'i paraqitet dosja fizike e deklaratës së tij. Së dyti, ai ka kërkuar kohë për kundërpjetje për të parë se çfarë po vendoset. Prokurorja Vega Iodice ka thënë se do t'ua tregojnë materialet përpara se të fillojnë kundërpjetjet e mbrojtjes.



KOSOVA DHE MASAT E BE-SË: NJË NGËRÇ ME PASOJA TË ZGJATURA

Masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian nuk e kanë detyruar Qeverinë e Kosovës të ndryshojë kursin e saj, por kanë pasur ndikim në mirëqenien e qytetarëve. Pa një konsensus të qartë brenda BE-së se kur mund të hiqen, pasiguria vazhdon ta formësojë situatën

PRISHTINË, 24 SHKURT - Njëzet muaj pas ngrirjes së fondeve për Kosovën dhe pezullimit të vizitave të nivelit të lartë, Bashkimi Evropian vazhdon ta refuzojë heqjen e këtyre masave pavarësisht prej kërkesave të vazhdueshme të Prishtinës, por edhe të Parlamentit Evropian. Në një përgjigje dhënë “Radios Evropa e Lirë”, një zëdhënësi i bllokut tha se “masat e përkohshme të BE-së janë të kthyeshme dhe Këshilli tashmë ka vendosur kushte për heqjen graduale të tyre, të cilat lidhen me marrjen e hapave nga Kosova për uljen e tensioneve në veri”.

Klisman Kadiu nga Zyra e zëvendëskryeministrit të parë të Kosovës, Besnik Bislimi, nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse qeveria e vendit ka ndonjë sinjal se kur do të hiqen masat e BE-së. Nuk u përgjigj as sa llogaritet të jenë humbjet nga to. BE-ja e ndëshkoi Kosovën në qershor të vitit 2023, për shkak të, siç vlerësoi, rolit të kryeministrit Albin Kurti në nxitjen e tensioneve etnike në veri të vendit - zonë e banuar me shumicë serbe. Pavarësisht prej masave, Kurti nuk u zbraps, hoqi nga përdorimi dinarin serb, mbylli shumicën e institucioneve të Serbisë dhe e

mbrojti këtë politikë si shtrirje të autoritetit. Në disa raste ai i cilësoi të padrejta masat e BE-së, duke thënë se nuk mund të bëjë kompromise me sundimin e ligjit dhe kushtetutshmërinë e vendit.

BE-ja nuk bëri me dije se cilat projekte konkretisht janë prekur nga pezullimi i fondeve për Kosovën, por burime të “Radios Evropa e Lirë” morën vesh se ato variojnë nga kultura deri tek infrastruktura dhe se vlera e tyre arrin deri në 100 milionë euro.

Fisnik Osmani, kryeshf ekzekutiv i Ngrohtores së Qytetit të Prishtinës “Termokos”, konfirmon se një projekt i ndërmarrjes për dyfishimin e kapaciteteve të ngrohjes në kryeqytet është pezulluar për shkak të ngrirjes së një granti prej 17.6 milionë eurosh nga Bashkimi Evropian. Këto mjete, thotë ai, ishin pjesë e programit IPA, që u ofron asistencë financiare dhe teknike vendeve që synojnë BE-në, por që në rastin e Kosovës është bllokuar. “Sanksionet e BE-së e kanë dëmtuar në masë të madhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në këtë rast, fatkeqësisht, është dëmtuar edhe Ngrohtorja e Qytetit, rrjedhimisht edhe qyteti i Prishtinës dhe qytetarët e tij”, thotë Osmani për programin

“Expose” të “Radios Evropa e Lirë”.

Ai tregon se projekti në total kushton 65 milionë euro, se mbi 15 milionë euro do të garantohen nga qeveria dhe komuna e Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër do të sigurohet përmes kredive. Osmani thotë se punimet është dashur të nisnin këtë vit, por se tani nuk është e sigurt. Ai, po ashtu, tregon se “Termokos”-i aktualisht mbulon mbi 25 000 familje në Prishtinë dhe se me projektin e ri, ky kapacitet do të dyfishohet dhe, rrjedhimisht, do të ulj konsumimi i energjisë elektrike dhe ndotja e ajrit. “Projekti parashihet zgjerimin në objekte shumëkatëshe. Pra, zgjerim masiv në Prishtinën e re, pjesa e Kalabrisë, pjesa e Mëhallës së Muhaxherëve, një pjesë e Arbërisë... Prishtina, praktikisht, do të përmbylej sa i përket ngrohjes, në momentin që të finalizohet projekti”, thotë Osmani.

Nga dita kur do të nisë ky projekt duhen tre vjet për t’u përfunduar, thekson ai. E për heqjen e masave ndëshkuese të BE-së kundër Kosovës nuk ka as edhe një afat formal, thotë Augustin Palokaj, gazetar që përcjell politikën e BE-së në Bruksel, për faktin se ato nuk janë sanksione klasike me afat të caktuar kohor, sipas tij. “Këto masa janë hibride në ndërmarrjen e BE-së, sepse për to nuk ka pasur një vendim të prerë formal, i cili do të shfuqizohej. Pra, nuk janë sanksione klasike. Janë masa që janë ndërmarrë nga institucionet e BE-së, duke u bazuar në një deklaratë politike, e që tash nuk ka pajtim nga të gjitha vendet anëtare që ato të hiqen”, thotë Palokaj.

Ai shton se diskutimet për to mbahen me dyer të mbyllura, por se nga burimet diplomatike ka marrë vesh se kundër heqjes së masave janë vende si: Franca, Italia, Sllovakia dhe Hungaria. Ato duan që heqja e tyre të ulj kushtetohet dhe të bëhet gradualisht.

Palokaj kujton se vendimet në BE merren me konsensusin e të 27 vendeve anëtare dhe thotë se Kosova nuk ka ndonjë mekanizëm diplomatik për ta negociuar heqjen e masave. “Ato janë masa për projekte që i financon BE-ja, pra janë financime të njëanshme, që nuk janë pjesë e marrëveshjeve formale me Kosovën. BE-ja i jep si grante për projekte, por edhe mund t’i ndalë vetë. Menaxhimi i tyre bëhet nga BE-ja dhe përfituesi nuk ka mekanizma për ta detyruar atë që t’i japë ato mjete”, thotë Palokaj.

Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politikën në Prishtinë, thotë se Kosova ka mënyra për ta bindur BE-në që t’i heqë masat dhe numëron disa prej tyre: “Kosova duhet të merret me procesin e agjendës evropiane. Duhet të krijojë një udhërrëfyes të veprimeve në veri, derisa të vijë në situatën që serbët të kthehen në institucione, të mbahen zgjedhjet e lira atje dhe të fillojë procesi i normalitetit. Ky besoj se është kushti që po e pret BE-ja”.

Rashiti thotë se masat ndëshkuese nuk kanë pasur ndikim në sjelljen e institucioneve të Kosovës dhe i quan “fatkeqësi” me pasoja afatgjatë. “E para, masat e kanë larguar më shumë Kosovën nga proceset integruese, kanë vendosur barriera shtesë, kanë ulur besimin skajshmërisht dhe

u kanë dhënë argumente shumë zyrtarëve dhe burokratëve evropianë, të cilët mezi kanë pritur të kenë diçka për të mos e vendosur agjendën e Kosovës në binarë pozitivë. Ky është dëmi më i madh, pastaj vjen edhe çështja e ndaljes së projekteve, investimeve, programeve e kështu me radhë”, thotë Rashiti.

Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk është kandidatë për anëtarësim në BE. Ajo ka aplikuar për t’iu bashkuar bllokut 27-anëtarësh qysh në dhjetor të vitit 2022, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Pavarësisht prej kësaj situatë, Palokaj thotë se nuk shihet ndonjë rrezik për rritjen e euroskepticizmit në Kosovë, ndaj BE-ja, sipas tij, ndihet tejet komode me veprimet e veta.

“Kosova ka qenë e diskriminuar në shumë fusha të tjera dhe kjo nuk ka ndikuar që të ulet mbështetja e kosovarëve për Bashkimin Evropian. Kosova është mbajtur pa liberalizim vizash me vite dhe mbështetja për BE-në në vend ka qenë më e madhja në rajon dhe Evropë. Masat ndëshkuese krijojnë dëshpërim me BE-në, por nuk shndërrohen në euroskepticizëm apo në kundërshtim të BE-së nga ana e qytetarëve”, thotë Palokaj.

Këtë bindje e mbështet edhe një sondazh i Institutit Ndërkombëtar Republikan, me seli në Uashington, i kryer në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në periudhën shkurt-mars të vitit të kaluar. Sipas rezultateve të këtij studimi, 87 % e të anketuarve në Kosovë duan që vendi i tyre ta ndjekë kursin pro Bashkimit Evropian dhe pro-perëndimor, për dallim prej Serbisë ku

INVESTIMET E BEI-t SHËNUAN NJË VLERË PREJ 693 MILIONË EUROSH NË BALLKANIN PERËNDIMOR NË 2024

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 24 shkurt - Në vitin 2024 financimi i Grupit të Bankës Evropiane të Investimeve (BEI Globale) për projekte të reja në Ballkanin Perëndimor arriti në vlerën 693 milionë euro, projekte të cilat lidhen me sigurinë e energjisë, transportin e qëndrueshëm, masat për klimën, zhvillimet digjitale dhe kapitalin njerëzor. Nga këto fonde janë nënshkruar 527 milionë euro në kredi, 164 milionë euro në grante në kuadër të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP) dhe 2 milionë euro grante në Iniciativën për Qëndrueshmëri Ekonomike të BEI-së. Pjesa më e madhe e nënshkrimeve të reja iu nda transportit të qëndrueshëm (43 %), projekteve të energjisë së pastër (31 %, përqindje rekord) dhe sektorit privat (20 %). "Ne jemi plotësisht të përkushtuar për t'i mbështetur të gjitha vendet në rajon në rrugën e tyre drejt integritimit në BE. Arritja e një konvergjence më të lartë me Bashkimin Evropian kërkon reforma dhe investime të rëndësishme, prandaj mbështetja e kombinuar financiare dhe teknike nën ombrellën e Team Europe ofron një mbështetje koherente, të vazhdueshme dhe të gjerë. Plani i fundit i rritjes paraqet shembuj të nismave që mund ta përshpejtojnë integritimin e

tregut, rritjen ekonomike dhe ambiciet e pranimit në BE", ka theksuar zëvendës-presidenti i BEI-t, Robert de Groot.

Mbështetje për projektet e energjisë

Banka dha kredi me vlerë 213 milionë euro për rehabilitimin e disa hidrocentraleve të mëdha dhe instalimin e matësve të avancuar të energjisë elektrike në Serbi. Përveç kësaj, banka financoi ndërtimin e një prej termocentraleve më të mëdha diellore afër Prishtinës në Kosovë*, i cili do t'i adresojë nevojat energjetike të mbi 29 000 familjeve dhe do të shkurtojë 174 000 tonë emetime dioksidi karboni në vit. "Si bankë e BE-së për klimën, ne kemi intensifikuar përpjekjet tona për të promovuar një tranzicion të gjelbër në secilin vend dhe jemi të palëkundur në angazhimin tonë për të mbështetur dekarbonizimin e ekonomive rajonale me qëllim garantimin e sigurisë energjetike dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit", ka deklaruar zëvendës-presidenti De Groot. Banka vuri gjithashtu në dispozicion programin këshillues të sistemeve financiare të gjelbra në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të rrezikut klimatik të bankave

kombëtare dhe lokale dhe investimet e gjelbra të kompanitë.

Disa projekte të financuara nga BEI përfituan nga asistencë teknike në kuadër të programit këshillimor të KIBP dhe asistencës së përbashkët për mbështetjen e projekteve në rajonet evropiane (JASPERS). Që nga nënshkrimi i mandatit të tretë në vjeshtën e vitit 2023, ekspertët e JASPERS kanë përbushur 32 detyra këshilluese në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke mbuluar sektorët e transportit, ujit, energjisë, urban dhe digjital.

Avancimi i lidhjes së qëndrueshme në vitin 2024

Në vitin 2024 BEI Globale vijoi ta mbështesë sektorin e transportit me financime të reja me vlerë 295 milionë euro. Këto përfshinë marrëveshje për rehabilitimin e seksioneve hekurudhore në Mal të Zi dhe Shqipëri. Këto përmirësime të infrastrukturës përgjatë rrjetit të zgjeruar të transportit transevropian (TEN-T) do të rrisin kapacitetin, efikasitetin dhe sigurinë hekurudhore, duke promovuar një zhvendosje nga transporti rrugor në transport të qëndrueshëm. Për më tepër, Banka nënshkroi grant të BE-së me një vlerë totale prej 79 milionë eurosh për ndërtimin e një seksioni në Korridorin Vc në Bosnjë dhe Hercegovinë.



Nxitja e krijimit të vendeve të punës dhe masat për klimën në kompanitë rajonale

BEI Globale investoi 151 milionë euro për të mbështetur projektet e zgjerimit, punësimit, inovacionit dhe energjisë së pastër të kompanitë. Falë linjës së tij të parë të kredisë së bazuar në ndikim, bizneset e vogla në rajon kanë krijuar vende të reja pune, kanë ofruar trajnime dhe mundësi zhvillimi të karrierës për njerëzit nga grupet e cenueshme. Në kuadër të Instrumentit të Garancisë për Inovacionin dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve në Ballkanin Perëndimor (WB EDIF) lidhur me qëndrueshmërinë e NVM-ve në Bashkimin Evropian,

Fondi Evropian i Investimeve, pjesë e Grupit të BEI-t, siguroi garanci që pritjet të zhblokojnë kredi me vlerë mbi 750 milionë euro për rreth 13 000 biznese të vogla, duke mbështetur rreth 180 000 vende pune.

Banka Evropiane e Investimeve është institucioni kreditues afatgjatë i Bashkimit Evropian, në pronësi të shteteve të tij anëtare. Ajo financoi investime që kontribuojnë në qëllimet e politikave të BE-së. Projektet e BEI-t forcojnë konkurrencën, nxisin inovacionin, promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm, përmirësojnë kohezionin social dhe territorial dhe mbështesin një tranzicion të drejtë dhe të shpejtë drejt neutralitetit klimatik. BEI është një nga financuesit kryesorë ndërkombëtarë në Ballkanin Perëndimor.

Vdiq Frank Wisner, diplomati amerikan që shërbeu i dërguar special i ShBA-së në bisedimet për statusin e Kosovës

PRISHTINË, 24 SHKURT - Frank Wisner, diplomati amerikan që ka shërbyer i dërguar special i ShBA-së në bisedimet për statusin e Kosovës para shpalljes së pavarësisë, ka vdekur në moshën 86-vjeçare, raporton "Washington Post". Wisner, një burrështetas i vjetër i politikës së jashtme amerikane, i cili ka punuar ambasador në katër vende dhe i ka këshilluar korporatat për çështjet globale dhe ka dalë nga pensioni për të

ndihmuar në negociatat delikate në Kosovë dhe Kajro, ka vdekur më 24 shkurt në Mill Neck, Nju-Jork. Shkaku i vdekjes ishin ndërlidhjet nga kanceri i mushkërive, ka thënë djali i tij David Wisner. Djali i një agjenti të dekoruar që ka ndihmuar në themelimin e CIA-s, Wisner është përfshirë në marrëdhënie me sekretarët e kabinetit dhe zyrtarët e Pentagonit kur ishte i ri, duke

shtrënguar duart me gjeneralin George C. Marshall dhe Allen Dulles, ndërsa prindërit e tij priten personalitete në shtëpinë e tyre në Georgetown. Në kohën kur ishte 13 vjeç ai ishte i vendosur të bëhej diplomat, shkruan "WP". "Unë mund t'i recitoja emrat e çdo kryeministri në botë", i kishte thënë ai revistës "Foreign Affairs". Administrata e George W. Bush kishte kërkuar ndihmën



e Wisnerit për ta negociuar statusin e Kosovës si shtet sovran, një përpjekje që rezultoi "kryesisht e suksesshme", siç shkruan

"WP", edhe pse Wisneri ishte ankuar që Serbia, fqinja veriore e Kosovës, ende refuzonte ta njihje pavarësinë e vendit.

vetëm 10 % e të anketuarve kanë dhënë përgjigje të njëjtë. Rashiti, megjithatë, paralajmëron se nëse masat ndëshkuese të BE-së vazhdojnë edhe për një kohë, ato do të ndikojnë keq në marrëdhëniet afatgjatë të Kosovës me BE-në, sidomos tash kur zhvillimet politike në botë ndryshojnë

nga dita në ditë. "Në këto ditë që flasim nuk e di se sa kohë do të kenë [shëfja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja] Kallas dhe [presidentja e Komisionit Evropian, Ursula] von der Leyen të merren me Ballkanin Perëndimor, apo në mënyrë specifike me Kosovën. Hapësira është duke u ngushtuar gjithnjë

e më shumë. Shtresat e vështirësive janë duke u rritur më shumë dhe ato janë jashtë kontrollit të Kosovës, por Kosova i ka disa elemente në duar dhe duhet të mobilizohet shpejt për të dalë nga kjo kthetër", thotë Rashiti. Këtë javë Parlamenti Evropian ka kërkuar edhe një herë nga

BE-ja që t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës, duke thënë se "ato janë në kontradiktë me përkushtimin e dëshmuar të Kosovës ndaj vlerave evropiane dhe me përshtatjen e saj me politikën e BE-së". Po këtë javë shefi i Zyrës së BE-së në Prishtinë, Aivo Orav, ka

kujtuar se për heqjen e masave duhet konsensusi i të 27 shteteve të BE-së, dhe ka thënë se diskutimet për këtë çështje janë në proces e sipër. Se kur dhe si do të mund të përfundojnë ato bisedime, është e paqartë, siç ndodh shpesh kur në pyetje janë politikën e BE-së.

CILI/CILA DO TË JETË JUDA ISKARIOTI PËR FORMIMIN E QEVERISË?



Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA

Sinonim i tradhtisë: Sipas mësimëve fetare Juda Iskarioti ishte ai që për 30 monedha argjendi e shiti Jezu Krishtin të cilin Poncije Pilati e dënoi me kryqëzim. Pas kësaj Juda Iskarioti ia dorëzoi trupin e Jezu Krishtit farisejve. Juda Iskarioti ishte njëri prej 12 apostujve e që në Darkën e Fundit Krishti, pasi ia ofroi një copë bukë tha: "Këtij që ia dhashë bukën do të më tradhtojë. "Juda Iskarioti ishte hajn, një faqezi dhe një kumarxhi prandaj i duheshin paratë. Para se ta tradhtonte, Juda e puthi Jezusin në faqe. Përkundër të gjitha të zezave që i kishte, pasi u ballafaqua me ndërgjegjen, Juda Iskarioti bëri vetëvrasje duke u vetëvarur në një dru, emri i të cilit nuk më kujtohet por se tash quhet Druri i Judës - Druri i Tradhtisë. Tash, jo vetëm në literaturën a jetën kishtarë, emri i Judës është sinonim i tradhtisë, pafytyrësisë, ligësisë dhe poshtërsisë. Edhe te ne shqiptarët është një bindje e ashtëzuar se ai që i beson shumë, që e ke mbajtur me bukë apo iu ke gjetur në

situata të rënda, pikërisht ai të tradhton.

Po ç'ka të bëjë situata aktuale në Kosovë me Judën, me të drejtë mund të pyesni?! Ta gjejmë fillin dhe kuptimin e ndërlydhjes midis Judës dhe situatës në Kosovë. Pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, as pozita e as opozita nuk kanë mundësi ta formojnë një qeveri të qëndrueshme kurse, me blerjen e ndonjë Jude apo Judeshe mund ta bëjnë një qeveri me 61 - 63 deputetë që, përveç se është e thyeshme, ajo është shumë e shantazhueshme. Dolën fjalë se kinse Albin Kurti e ka blerë një deputet të PDK-së, i blenë edhe disa nga opozita dhe në këtë mënyrë e formon qeverinë e pakicës apo qeverinë e zorit. Për t'ua dhënë një vërtetësi këtyre spekulimeve u përkujdes kandidati më serioz për t'u bërë Juda Iskarioti i politikës kosovare - Fatmir Limaj që vet iu ofrua Pont Pilatit të Kosovës - Albin Kurtit. Tradhtinë dhe mercenarizmin politik e ka përligjur pikërisht Albin Kurti që e pati kontrabanduar një Judeshë nga PDK-ja në zgjedhjet paraprake, sigurisht jo me 30 monedha argjendi por mbase me tenderë, punësime apo edhe para të Martinit. Atëherë Kurti shkeli "murin e zjarrit" duke e vrarë parlamentarizmin, votën qytetare, vullnetin e popullit, për një bythë karrige. Të njëjtën lojë, të pistë pa asnjë dyshim mund ta luaj edhe tani, aq

më parë që tani e ka punën piskë për formimin e qeverisë. Albini nuk po peshkon deputetë por po blenë me para të popullit mercenarë të parapolitikës, njerëz pa fije morali që nesër, sigurisht jo për 30 monedha të argjendit janë në gjendje ta bëjnë çdo tradhti. E tradhtojnë edhe Albinin nëse dikush nesër iu ofron më shumë se Albini. Këta mercenarë janë dalë në treg, e kanë një çmim por nuk kanë asnjë parim njerëzor, kombëtar, politik apo moral. Albinin kesi i duhen prandaj edhe i lypë, me strajcë në krahë. Kontrabandimi me njerëz dhe panjerëz është vepër penale, ndiqet dhe dënohet në ligj. Kontrabandimi me mendermethënë deputetë është biznes shumë fitimprurës, për partinë dhe deputetin mercenar. Partia blenë deputetë me para të popullit, plus fiton shumë kurse deputeti i prostituar politikisht fiton shumë para që me prostitucion klasik nuk do të fitonte aq shumë edhe të ishte vet Stormy Daniels, e ngatërruar dikur me Trampin.

Si të bëhet qeveria: Opozita gabon nëse shpenzon kohë dhe mund ta formojë qeverinë, asgjë nuk fiton dhe vetëm do të dobësohet. Nëse Albin Kurti nuk i siguron numrat e unë besoj se nuk do të lë gjë pa bë për të siguruar numrat, nëse vjen radha e opozitës për ta formuar qeverinë, nuk duhet ta bëjnë këtë.

Opozita po trashëgon vetëm probleme dhe nëse e formon qeverinë do të detyrohet t'i hajë të gjitha m...rit që i ka bërë Albin Baba, me 40 hajdutët e tij. Opozita aktuale duhet të përqendrohet në zgjedhjet lokale sepse, pavarësisht kush e formon qeverinë, pa një koalicion të madh nuk do të sigurojë qeverisje efektive. Pastaj, nëse i kemi parasysh zhvillimet globale ku ne nuk jemi kurrfarë faktori, nuk pyeteni për asgjë dhe nuk mund të vendosim as për veten tonë, ai që do të qeverisë do të jetë humbësi më i madh. Me gjasë do të detyrohemi t'i veshim teshat e prera nga të tjerët, nga ata që vendosin. Trump po i kërkon Zelenskit 500 miliardë dollarë në emër të ndihmave që i ka dhënë Amerika Ukrainës për luftë. Nëse i shkon mendja të na kërkojë edhe neve kthimin e borxhit për intervenim ushtarak dhe ndihmat tjera. Ka shumë rrezik që në bisedimet midis Tramp dhe Putin të vendoset edhe për Kosovën, pa e pyetur fare Kosovën. Mësa po pyetet Ukraina për Ukrainën. Kosova do të humbë, pa asnjë dyshim prandaj duhet një përbashkim i faktorit politik shqiptar që këto humbje të jenë sa më të vogla dhe të përbalueshme. Vuçiqi po kërcënon me luftë, Albini qeveri vjet na ja teshë bythën me rrezik për luftë ndonëse qeveria dhe deputetët që i ka nuk janë të gatshëm ta shkrepin as

një pordhë të vetme e lëre më të bëjnë luftë. Lufta nuk është e mirë për askënd, e kemi provuar, disa duke luftuar e vdekur për Kosovën e që nuk janë askund përveç se janë në burg të Hagës dhe të tjerët që kanë luftuar për Jugosllavinë dhe Serbinë, kundër Kosovës dhe shqiptarëve e që janë në qeveri të Kosovës, deputetë, ambasadorë etj. Shpresoj të mos ketë luftë dhe nëse do të ketë atëherë do të jetë luftë midis serbëve dhe shqiptarëve, pavarësisht shtetit apo vendit ku jetojnë. Vetëm mos të ngutet Serbia deri ta ndërtojë fabrikën e municionit. Çfarë rrenci ky Komandant Pasuli, pak po i duken rrenët në Kosovë ku nuk i beson askush, në Tajvan nuk e njohin, mund dikush edhe t'i besojë.

Ne po i nxjerrim sytë shoqi - shoqit kurse një telefonatë nga të huajt e bënë qeverinë, koalicionin që ua zbaton marrëveshjet e jo Judët dhe Judeshat që çdo gjë e bëjnë për para dhe poste, të zhveshur nga çdo ndjenjë e moral njerëzor, politik dhe kombëtar. Me të tillët Albin Kurti do ta bëjë qeverinë dhe ta sigurojë lavdinë, të turpshme, të padinjitetshme dhe të ulët. Poshtë ka ra katundi kur një kryeministër me mbi 300.000 vota del me strajcë në krah mos ndoshta pasi të lirohet nga paratë e Martinit, në vend të tyre e futë ndonjë deputet a deputete, Judë apo Judeshë, gjithsesi!

Nga 1 marsi patentëshoferët e Kosovës, të barabartë me ata të Austrisë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Nga 1 marsi zyrtarisht patentëshoferët e Kosovës do të njihen edhe në Austri. Lajmin e ka dhënë Ambasada e Austrisë.

Në njoftim thuhet se patentëshoferët e Kosovës u njohën në Austri më 1 shtator 2023, me miratimin e marrëveshjes për krijimin e Bashkësisë së Transportit në nenin 23 të Ligjit për Patentë Shoferët (FSG). "Bazuar në këtë, mbajtësit e patentë-shoferëve kosovarë kanë të drejtën të drejtojnë automjetet përkohësisht në Austri. Nëse

qëndrojnë mbi 6 muaj në Austri ose vendosin vendbanimin në Austri, duhet të konvertojnë patentëshoferin kosovar. Megjithatë, patentëshoferët kosovarë nuk ishin të barabartë me ata austriakë, ndaj konvertimi kërkonte një provim praktik të vozitjes", thuhet në njoftim.

Ambasada e Austrisë shpjegon edhe ndryshimet procedurale që kanë ndodhur. "Tani, me ndryshimin e rregullores përkatëse, që nga 1 marsi 2025, patentëshoferët e Kosovës të të gjitha kategorive do të jenë të barabartë me

patentëshoferët austriakë. Kjo do të thotë se patentëshoferët kosovarë, që nga ky moment, mund të konvertohen në Austri pa pasur nevojë për një provim praktik të vozitjes, nëse qëndrohet mbi 6 muaj në Austri ose vendoset qëndrimi i përhershëm në Austri", thuhet në njoftimin për medie, duke bërë me dije se me këtë ndryshim të rregullores, Austria plotëson një kërkesë të rëndësishme dhe konkrete të ekonomisë dhe të gjithë atyre që posedojnë një patentëshofer të shtetit të Kosovës.



Ushtria turke trajnon FSK-në për përdorim të granatahedhësit automatik 'MK-19'

PRISHTINË, 24 SHKURT - Në kuadër të bashkëpunimit me Forcat e Armatosura Turke, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve luftarake të Forcës së Sigurisë së Kosovës,

është realizuar trajnimi nga ekipet turke për përdorimin sa më të mirë të armës granatahedhëse automatik MK-19. Ky trajnim ka për qëllim përmirësimin e

aftësive operative të ushtarëve dhe rritjen e gatishmërisë luftarake për përballimin e sfidave të ndryshme në misionet e ardhshme. Pjesëmarrësit në

trajnim kanë kaluar një proces intensiv, ku janë njohur me karakteristikat teknike, përdorimin në terren, procedurat e sigurisë dhe rolin e saj në fushëbetëje.



Të mërkurën nis numërimi i votave të diasporës, të personave me aftësi të kufizuara dhe atyre me kusht

PRISHTINË, 24 SHKURT - Më 23 shkurt janë bërë dy javë qëkur në Kosovë janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme, mirëpo ende nuk ka rezultate përfundimtare, e numërimi i votave të rregullta ka mbaruar të premtën.

Të panumëruara kanë mbetur votat e diasporës, me kusht dhe të personave me aftësi të kufizuara. Numërimi i tyre pritet të fillojë të mërkurën. Kështu ka thënë për "Express" anëtari i PDK-së në KQZ, Arianit Elshani.

Ai ka thënë se kjo është duke u bërë sipas afateve të parashikuara nga KQZ-ja. "Është duke u pritur skanimi. Nëse e shikoni planin e aktiviteteve të miratuar nga KQZ-ja, është sipas afateve", ka thënë ai.

Nga KQZ-ja kanë thënë se numërimi i votave me kusht, të mërgatës dhe të personave me aftësi të kufizuara do të bëhet gjatë kësaj jave, mirëpo nuk

kanë dhënë ndonjë datë të saktë.

Sa iu përket votave me postë, nga 9 shkurti deri më 22 shkurt janë verifikuar 60 mijë e 997 pako, prej tyre janë refuzuar 4 050 sosh. Këtij procesi do t'i nënshtrohen edhe 7 718 pako me fletëvotime.

Në përfaqësi diplomatike kanë votuar 15 352 votues, ndërsa në votimin përmes postës KQZ ka pranuar rreth 69 mijë pako me fletëvotime.

Vota me kusht janë 12 801, ndërsa numri i personave me nevoja të veçanta është 2 597. Sipas rezultateve, liderët e partive kryesore dhe kandidatët për pozitën e kryeministrit renditen kështu: Albin Kurti, lider i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidat për kryeministër - 259 532 vota; Bedri Hamza, kandidat për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës - 150 294 vota; Memli Krasniqi, lider i Partisë Demokratike të



Kosovës - 85 293 vota; Lumir Abdixhiku, lider i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kandidat për kryeministër - 109 202 vota; Ramush Haradinaj, lider i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidat për kryeministër - 37 752 vota; Zllatan Ellek, lider i Listës Serbe - 9 354 vota.

Në rezultatit e publikuar nuk përfshihen votat me kusht,

votat e personave me nevoja të veçanta dhe mbi 80 mijë vota nga diaspora.

Personi më i votuar në Kosovë vazhdon të mbetet presidentja aktuale e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila në zgjedhjet e vitit 2021 pati fituar 300 756 vota.

Dalja në zgjedhjet e sivjetme ishte 40 për qind - rreth 8 për qind më e vogël se në zgjedhjet

e 2021-s.

Lëvizja Vetëvendosje (LV) - parti në pushtet - ka dalë e para në këto zgjedhje, me 40.80 për qind të votave, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 22.03 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 17.63 për qind të votave, koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Socialdemokrate ka marrë 7.46 për qind të votave, si dhe Lista Serbe 4.61 për qind të votave.

Partitë e tjera kanë fituar përqindje më të vogël të votave.

Me Ligjin e ri për Zgjedhjet, votat e kandidatëve për deputetë numërohen ndaras në Qendrat Komunale të Numërimit. Ky proces ka nisur me vonesë, ndërsa organizatat për monitorim të zgjedhjeve e kanë kritikuar KQZ-në se nuk është përgatitur mjaftueshëm mirë për procesin.

UP-ja rrit ndikimin, lidh marrëveshje edhe me një universitet në Tajvan



PRISHTINË, 24 SHKURT - Universiteti i Prishtinës ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Universitetin Nacional Sun Yat-Sen të Tajvanit. Lajmin për nënshkrimin e këtij memorandumit nga pala tajvaneze ua bëri me dije nëpërmjet një emaili rektorit Arben Hajrullahu dhe prorektore Rozafa Basha, drejtoresha për marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin Nacional Sun Yat-Sen të Tajvanit, Tanya Hsu. Në njoftimin e saj, Hsu shprehu

kënaqësinë që do ta shtojë Kosovën në listën e vendeve ku do të shkojnë studentët nga Tajvani, ndërsa tha se mirëpret edhe studentët e UP-së që në të ardhmen e afërt mund të studiojnë në këtë vend, duke iu bashkuar komunitetit ndërkombëtar atje.

Memorandumi i nënshkruar nga rektorët Arben Hajrullahu dhe Chih-Peng Li ka për qëllim ta shtojë dhe ndihmojë bashkëpunimin akademik në fushat e trajnimit, kërkimit, zhvillimit të kurrikulës,

edukimit pasuniversitar dhe shkëmbimit të studentëve dhe personelit mësues.

Para se të nënshkruhej memorandumit, në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës gjatë janarit të vitit 2025 kishte ardhur për një takim Anna Y. C. Ho, zëvendës drejtoresha e Zyrës Përfaqësuese të Taipeiit në Hungari.

Atëherë ishte folur rreth bursave që mund të ofrojnë Universiteti Nacional i Tajvanit për studentët e Universitetit të Prishtinës.

KFOR-i dhuron radio për njësinë e shërbimit të Zjarrfikësve në Novobërdë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ushtarë dhe drejtues të Komandës Rajonale Lindore të misionit të udhëhequr nga KFOR-i morën pjesë në një ceremoni donacioni në Stacionin e Zjarrfikësve të Novobërdës. KFOR-i i dhuroi departamentit radio të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e aftësive të zjarrfikësve dhe vullnetarëve. "Radiot përmirësojnë komunikimin brenda

departamentit të zjarrit, zvogëlojnë kohën e reagimit dhe rrisin sigurinë. Këto përpjekje janë pjesë e misionit të përditshëm të KFOR-it për të garantuar një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë", ka njoftuar KFOR-i.

KFOR-i vazhdon ta zbatojë mandatin e tij - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999

- për të kontribuar në një mjedis të sigurt dhe të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme. KFOR-i punon në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në rolet e tyre përkatëse si reagues të sigurisë.



Brenda dy javësh hapet thirrja për subvencionim të fermerëve

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ministria e Bujqësisë brenda dy javësh do ta hapë thirrjen për fermerët për Programin e Pagesave Direkte/ Subvencione 2025. Kështu ka bërë me dije në rrjetin social në "Facebook", ministri i Bujqësisë, Faton Peci. Sipas tij, procesi i

subvencionimit do të monitorohet me teknologjinë më të avancuar, përfshirë imazhet satelitore të fundit. "Të dashur fermerë, brenda dy javësh hapet thirrja për aplikim në Programin e Pagesave Direkte/ Subvencione 2025! Këtë vit

kemi bërë një hap shumë të rëndësishëm drejt forcimit të transparencës dhe meritokracisë, pasi procesi i subvencionimit do të monitorohet me teknologjinë më të avancuar, përfshirë imazhet satelitore të fundit. Kjo do të mundësojë një

verifikim milimetrik të çdo prone bujqësore, duke siguruar një proces të drejtë dhe eliminimin e çdo tentative për abuzim", ka thënë Peci. Ai i ka ftuar fermerët që pas dy javësh të aplikojnë në mënyrë korrekte dhe të përfitojnë nga ky program.



Kosova në krizë investimesh? Ekspertët kërkojnë qasje të re nga institucionet

PRISHTINË, 24 SHKURT - Kosova ka nevojë për më shumë investime të huaja të cilat do ta rrisin nivelin e zhvillimit ekonomik, edhe atë të punësimit. Kështu po vlerësohet nga njohës të ekonomisë të cilët këtë mundësi po e shohin më të vështirë, marrë parasysh imazhin e Kosovës në vendet perëndimore. Sulmet terroriste në dy vitet e fundit dhe deklaratat e udhëheqësve politikë për rrezikun nga lufta vlerësohen të kenë pasur efekt negativ në aspektin e investimeve të huaja në Kosovë. I shqetësuar me këtë situatë është kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, i cili thotë se është i dëmshëm krijimi i imazhit të Kosovës si vend jostabil për investime. Andaj, ai udhëzoi në ndryshojë qasja e institucioneve këtë vit. "Ne

ende konsiderohemi si vend i tensioneve, si vend i luftës, si vend që kemi problem me veriu. Duhet të ndalen deklaratat e udhëheqësve të institucioneve duke filluar nga presidenti, kryeparlamentari e presidentja që thirren se Kosova do të sulmohet nga Serbia, ose që ushtrinë e kemi afër kufirit. Këto deklarata nuk e ndihmojnë ardhjen e investimeve të huaja. Duhet punuar me Komisionin Evropian për t'i ndaluar masat ndëshkuese", ka thënë Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike. Rafuna thotë se pavarësisht se ka rritje të investimeve, ato janë bërë në patundshmëri që, sipas tij, ajo nuk kanë ndikim në rritjen e nivelit të punësimit dhe zhvillimin ekonomik. E kritike, sipas tij, mbetet edhe mungesa e gatishmërisë së institucioneve për të ndihmuar



në qëndrueshmërinë ekonomike. "Nëse i shohim investimet e vitit të kaluar, rreth 650 milionë kanë shkuar në patundshmëri. Ne duhet t'i ndihmojmë diasporës, gjithë këto mjete duhet t'i riorientojmë në objekte zhvillimore për vendin. Mirë që kanë bërë banesa e shtëpi, por nëse nuk i

shfrytëzojmë, s'është investim, por shpenzim", ka thënë Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike. Njëzëri shprehen edhe njohës të ekonomisë të cilët thonë se institucionet duhet ta kenë prioritet edhe lehtësimin e procedurave për investitorët. "Për investimet e huaja direkte

flitet më së shumti, por bëhet më së paku. Duke nisur prej procedurave burokratike e deri te marrja e licencave për të hapur biznese e pritja për to është tejet e gjatë. Mungesa e digjitalizimit të tyre ka bërë që ky proces të stagnojë. Pa përmendur faktin e krizës me energji, situatës jo të favorshme në vend. Krahas kësaj, mbetet edhe hendeku në mes nevojave të tregut dhe përgatitjes së fuqisë punëtore", ka thënë Uran Radoniqi, njohës i ekonomisë. Sipas BQK-së, për periudhën janar-shtator 2024 investimet e huaja direkte kanë arritur në 657.3 milionë euro, një rritje kjo mbi 6 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Megjithatë, sipas BQK-së, krahasuar me vitet paraprake, ka ulje të trendit të rritjes. Investimet dominohen kryesisht nga aktivitetet e patundshmërisë me 71.4 %. (Dukagjini)

"Drena" ua hap dyert të gjithë fermerëve vendorë

Ditëve që lamë pas në qumështoren "Drena" ka pasur shumë telefonata nga fermerët pas rritjes së sasisë së qumështit dhe rënies së konsumit (rezultat i rënies së fuqisë blerëse dhe rritjes së pakontrolluar të importit të këtij produkti). "Drena" i njofton të gjithë fermerët se do t'u dalë në ndihmë. Do t'jua grumbullojë qumështin e tepërt. Ajo që kërkohet nga fermerët është ta kenë pëlqimin e pikës ose qumështores me të cilën janë duke bashkëpunuar. Çmimi për litër qumështi gjatë gjithë kohës do të jetë i pandryshueshëm (për një vit). Për më pak se një dekadë që nga fillimi i saj, kompania "Drena" tashmë është bërë storie suksesi



në industrinë e qumështit. Çdo vit kompania ka arritur rritje të jashtëzakonshme mbi 40 %, një dëshmi e përkushtimit të tyre ndaj cilësisë dhe inovacionit. Gama e produkteve të qumështit shquhet jo vetëm për shije unike, por edhe për vlera ushqyese, pasi "Drena" ka prioritet përbërësit organikë

dhe, sipas standardeve, më të lartat të cilësisë. Llojllojshmëria e produkteve që ka kjo kompani, nga qumështi UHT, djathërat tradicionale, kos fshati, mazë, jogurtët kemozë, kefirat etj., ka bërë që "Drena" të krijojë një bazë besnike klientësh, që e vlerësojnë përkushtimin e markës ndaj

përsosmërisë. Si pjesë e strategjisë kjo kompani ka edhe bashkëpunimin e shkëlqyer me fermerët vendorë. Duke vendosur marrëdhënie të drejtpërdrejta ato jo vetëm që sigurojnë një zinxhir të besueshëm furnizimi, por mbështesin bujqësinë lokale. Ky bashkëpunim shpesh përfshin aktivitete dhe bashkëpunim me fermerët për t'i përmirësuar praktikatat e qëndrueshme, gjë që përputhet me përkushtimin e "Drenës" ndaj produkteve natyrale vendore. Parimi "Rritemi së bashku" thekson përfitimet reciproke. Kjo është edhe pjesë e strategjisë së kompanisë, që duke punuar në bashkëpunim me fermerët dhe partnerët financiarë, mund të zhvillohen sinergji që rrisin

produktivitetin dhe inovacionin. Fermerët përfitojnë nga tregu i sigurt dhe praktikatat e reja që rrisin rendimentet, ndërsa "Drena" fiton qasje në një furnizim të besueshëm të përbërësve me cilësi të lartë. Ndërtimi i marrëdhënieve të forta me palët kryesore të interesuara si fermerët, konsumatorët dhe partnerët e komunitetit, nxit besimin dhe besnikërinë. Duke i dhënë përparësi komunikimit dhe bashkëpunimit të hapur, "Drena" shumë herët i ka kuptuar nevojat dhe sfidat e partnerëve të saj. Kjo qasje njerëzore ndihmon në kultivimin e një komuniteti që ndan një qëllim të përbashkët të qëndrueshmërisë dhe cilësisë. Drena, dritë në çdo shtëpi!

Bie numri i përfituesve nga ndihma sociale

Prishtinë, 24 shkurt - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e mirëqenies sociale për muajin janar 2025. Në muajin janar 2025, krahasuar me muajin janar 2024, kishte rritje të numrit të përfituesve nga skema për pensionet e Trepçës (-20,5 %);

skema për pensionet invalidore (-17 %); skema e ndihmës sociale (-11,4 %); skema për pensionet familjare (-6,3 %); skema e kompensimeve për personat e verbër (-3,1 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,8 %); skema e pensioneve për personat me

aftësi të kufizuara (-1,3 %); skema e pensioneve kontributpaguese të moshës (-1,2 %). Në muajin janar 2025, krahasuar me muajin janar 2024, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për përkrashje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të

kufizuara (17,7 %); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (11,6 %); skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (8,3 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (4,7 %); skema e pensioneve të Trupave



Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,9 %); skema e pensioneve bazike të moshës (3,8 %); skema për veteranët e luftës (0,2 %).

IT'S THE ENERGY, STUPID!

Bota e Trumpit. Kjo është loja e madhe për energjinë

E kanë quajtur "power play" e Donald Trumpit. Një lojë fjalësh: në politikë, ashtu si në sport, do të thotë një demonstrim force, një shfaqje superioriteti. Por power do të thotë edhe energji dhe, në rastin e Trumpit, përshkruan strategjinë e tij energjetike të ndërtuar mbi objektivin për të forcuar primatin amerikan: një bast agresiv mbi burimet e lëndëve djegëse fosile, naftën dhe gazin natyror, duke u mbështetur në deregullimin dhe thjeshtimet e burokracive, për të çliruar potencialin e vendit, duke lënë mënjanë shqetësimet për klimën dhe atë që ai e cilëson si një vëmendje të tepruar ndaj burimeve të rinovueshme.

Pikërisht për këtë arsye, me një nga urdhrat e tij të parë ekzekutivë, ai shpalli një "emergjencë energjetike", duke u mbështetur në Ligjin Kombëtar të Emergjencave: jo sepse SHBA-ja po përballet me mungesë energjie – Uashingtoni është tashmë lider global në prodhimin e burimeve fosile – por sepse ambicidet e tij shkojnë përtej thjesht thyerjes së rekordeve.

Këto objektiva përmblidhen në një slogan që premtion një bum të vazhdueshëm të shpimeve: "Drill, baby, drill! Do të jemi përsëri një komb i pasur dhe ari i lëngët nën këmbët tona do të na ndihmojë", ka deklaruar ai. Duke shtuar: "Do të ulim çmimet, do të mbushim në maksimum rezervat tona strategjike dhe do të eksportojmë energjinë amerikane në mbarë botën". Gjatë fushatës elektorale kishte premtuar përgjysmimin e çmimit të karburantit brenda një viti.

Por pasojat janë shumë më të gjera: pas retorikës pro-shpimeve ose pro-frakturimit hidraulik (fracking), fshihen objektiva strategjike me ndikime në sigurinë kombëtare, nga dominimi teknologjik deri te projektimi i fuqisë amerikane në politikën e jashtme.

Trump, jo rastësisht, është presidenti i parë që shpall një "emergjencë energjetike kombëtare": në vitet '70 pati vetëm emergjenca rajonale për shkak të mungesës së karburantit. Ai tani ka deklaruar se "prodhimi i pamjaftueshëm i energjisë, së bashku me transportin, rafinimin dhe prodhimin e saj në Shtetet e Bashkuara, përbëjnë një kërcënim të pazakontë dhe të jashtëzakonshëm për ekonominë kombëtare, sigurinë kombëtare dhe politikën e jashtme". Përgjegjëse për këtë situatë, sipas tij, janë "politikë miaoje të administratës së mëparshme".

Deklarata përcakton që departamentet dhe agjencitë federale duhet të eksplorojnë përdorimin e tokave publike, përfshirë shpronësimet kundrejt kompensimit, për të

"lehtësuar identifikimin, dhënien me qira, vendosjen, prodhimin, transportin, rafinimin dhe prodhimin e burimeve energjetike vendase". Në lojë është gjithashtu edhe përdorimi i Defense Production Act, i cili parashikon ndërhyrje nga Shtëpia e Bardhë për të përshpejtuar projekte thelbësore për vendin. "Emergjencia do të zhblllokojë një sërë kompetencash", ka siguruar një zyrtar i lartë i administratës.

Përdorimi i kompetencave të emergjencave lejon gjithashtu pezullimin e kufizimeve të përcaktuara në një sërë ligjesh mjedisore, duke filluar nga mbrojtja e specieve të rrezikuara, Endangered Species Act, deri te cilësia e ujërave, Clean Water Act. Ndërkohë, një urdhër ekzekutiv paralel ka krijuar Këshillin Kombëtar të Dominimit Energjetik, një organ ndërmëntor i drejtuar nga Sekretari i Brendshëm, Doug Burgum. Që nga themelimi i tij, ky organ ka si mision promovimin e industrive energjetike kombëtare duke centralizuar dhe koordinuar politikë energjetike si një shtyllë e sigurisë së vendit.

Energji për Inteligjencën Artificiale

Qasja e re mbi rëndësinë e prodhimit të energjisë ndërthuret, që në hapat e parë të administratës së re, me një tjetër fushë strategjike që ka implikime për sigurinë kombëtare dhe që SHBA-ja synon ta dominojë: inteligjenca artificiale, e cila ka rritur ndjeshëm kërkesën për energji elektrike, për funksionimin e qendrave të mëdha të të dhënave, të cilat po shtohen me shpejtësi. Kjo ka çuar në një riaktivizim të impianteve të vjetra të prodhimit të energjisë me qymyr, si dhe në hapjen e rrugës për termocentrale të kontrolluara drejtpërdrejt nga gjigantët e teknologjisë, përfshirë edhe reaktorë bërthamorë të gjeneratës së vjetër dhe të re.

Për partnerët e Uashingtonit, ky ndryshim është bërë i qartë përmes përmbyesjes së prioritetëve në skenën ndërkombëtare: SHBA-ja ka dalë menjëherë nga Marrëveshja e Parisit për Klimën, duke hequr dorë nga angazhimet për reduktimin e emetimeve, të cilat Trump i ka cilësuar si të dëmshme për interesat amerikane.

Nafta dhe gazi

Shtetet e Bashkuara nuk e kanë neglizhuar aspak prodhimin e naftës dhe gazit vitet e fundit. Ato janë tashmë eksportuese neto të energjisë së prodhuar nga burimet fosile dhe prej gjashtë vitesh kryesojnë botën për nga prodhimi i naftës dhe gazit natyror. Prodhimi



mesatar ditor ka kaluar 13 milionë fuçi.

Trump synon ta stimulojë edhe më tej këtë prodhim, ndonëse kërkesa dhe përfitueshmëria e investimeve do të jenë faktorët përcaktues, pavarësisht dëshirave të tij, sipas ekspertëve. Sekretari i Thesarit, Scott Bessent, ka theksuar se planet ekonomike të administratës bazohen në formulën "3-3-3": përveç zvogëlimit të deficitit buxhetor në 3% dhe rritjes ekonomike në 3%, administrata synon të rrisë prodhimin ditor të naftës me 3 milionë fuçi shtesë.

Gazi natyror dhe eksportet

Në sektorin e gazit natyror, masat e Trump mund të kenë ndikim më të shpejtë. Në tregun e brendshëm, gazi është tashmë burimi kryesor i energjisë elektrike, por është gjithashtu një burim kryesor eksporti, dhe tani mund të rritet akoma më shumë falë vendimit të Trump për të hequr ndalimin mbi lejet e reja për eksportin e gazit të lëngshëm dhe për të lejuar ndërtimin e terminaleve të reja. Ky vendim ka ardhur si kundërpërgjigje ndaj administratës së Joe Biden, e cila i kishte pezulluar për të shqyrtuar ndikimin e tyre mjedisor dhe ekonomik. Për më tepër, Trump ka shfuqizuar disa kufizime të tjera, përfshirë penalizimet mbi emetimet e metanit, një nga gazrat më të dëmshme për efektin serë, që lidhen me nxjerrjen e naftës dhe gazit.

E ardhmja e qymyrit

Megjithatë, sipas ekspertëve, Trump nuk ka gjasa të ndikojë ndjeshëm në ringjalljen e industrisë së qymyrit në një perspektivë afatgjatë. Ky sektor ka pësuar një rënie të thellë, dhe megjithëse qymyri ende përbën rreth 16% të prodhimit të energjisë elektrike, trendi i rënies duket i pashmangshëm.

Energjia bërthamore dhe rrjetet

Energjia bërthamore, ndryshe nga burimet e tjera, duket se do të luajë një rol qendror në dominimin energjetik të imagjinuar nga Shtëpia e Bardhë. Në radhë të parë janë disa teknologji të reja, si mini-

reaktorët ose reaktorët modularë të gjeneratës së re. Në kabinetin e Trump ka mbështetës të fortë të energjisë bërthamore: Chris Wright, Sekretari i Energjisë, ka qenë anëtar bordi në kompani që zhvillojnë teknologji të avancuara për reaktorë, si Oklo. Deri tani fokusi ka qenë te prodhimi, por edhe përkrahësit e politikave të Trump pranojnë se problemi kryesor nuk është prodhimi i energjisë, por infrastruktura e rrjetit elektrik, e cila është e papërshtatshme për rritjen e kërkesës.

Administrata është zotuar ta adresojë këtë sfidë, duke premtuar përshpejtimin e miratimeve dhe ndërtimit të sistemeve të transmetimit, të cilat zakonisht zgjasin me vite apo dekada. "Përshpejtimi i procesit të lejeve dhe vlerësimeve mjedisore për infrastrukturën e transmetimit mund të sjellë përmirësime", thuhet në një raport të bankës investuese Morgan Stanley.

Burimet e rinovueshme

Viktimat e paracaktuara të kësaj qasjeje, megjithëse mbetet për t'u parë deri në çfarë mase, janë burimet e pastra dhe të rinovueshme. Këto burime kanë qenë të mbështetura nga politika të mëparshme për të adresuar ndryshimet klimatike, një shqetësim që Trump e minimizon.

Dielli dhe era nuk janë përfshirë në përkufizimin e energjisë në dekretet e Trump, ku janë listuar vetëm nafta, gazi, uranumi, qymyri, biokarburantet, gjeotermia, hidrocentralet dhe mineralet e rralla. Kjo ndodh megjithëse burimet e rinovueshme përbëjnë 14% të prodhimit të energjisë elektrike, ku dominon energjia diellore dhe ajo e erës. Për më tepër, kompanitë private kanë investuar fuqishëm në këtë sektor, me 130 miliardë dollarë vetëm në dy vitet e fundit për panele diellore dhe bateri të fuqishme për ruajtjen e energjisë.

Trump dhe ekipi i tij i kanë cilësuar energjitë e rinovueshme si të pasigurta dhe të paqëndrueshme. Madje, ata kanë ngrirë çdo fond të miratuar më parë nga administrata e Joe Biden për burimet e pastra dhe tranzicionin energjetik, duke përfshirë Inflation Reduction Act, një paketë e madhe

investimesh në energjinë e gjelbër. Ata gjithashtu kanë bllokuar dhënien e lejeve dhe licencave për energjinë e erës, veçanërisht për projektet offshore. Trump, gjatë fushatës, i kishte kritikuar turbinat e erës për pamjen e tyre dhe dëmet e pretenduara ndaj faunës detare. Tani ai ka urdhëruar një rishikim të kontratave ekzistuese, me qëllimin për të gjetur arsye ligjore për anulimin e tyre.

Ekipi dhe industria

Anëtarët kryesorë të administratës së Trump për politikën energjetike janë të gjithë mbështetës të fuqishëm të industrisë fosile.

Lee Zeldin, ish-kongresmen, ka bërë të qartë se Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA) do të ketë një qasje shumë më të butë ndaj rregulloreve mjedisore.

Doug Burgum, ish-governatori i Dakotës së Veriut, ka theksuar rëndësinë e "prodhimit bazë", pra burimeve tradicionale të energjisë.



Chris Wright, Sekretari i Energjisë, ka qenë më parë CEO i Liberty Energy, një kompani që promovon fracking. Ai ka deklaruar se ndryshimi klimatik nuk është një krizë dhe se nuk jemi në një tranzicion energjetik. Në vitin 2019, për të demonstruar mbështetjen e tij për frakturimin hidraulik, ai piu para kamerave një lëng të përdorur në këtë proces, duke shkaktuar polemika.

Industria e naftës dhe gazit

Lobimi i industrisë së naftës dhe gazit, i përfaqësuar nga American Petroleum Institute, ka tashmë një aleat të sigurt në Shtëpinë e Bardhë dhe ka mirëpritur hapat e parë të administratës. Ata kishin kërkuar – dhe kanë marrë – miratimin e eksporteve të reja të gazit natyror të lëngshëm (GNL).

Administrata gjithashtu ka lehtësuar shfrytëzimin e tokave federale dhe ka propozuar hapjen e zonave të mbrojtura për kërkime të reja të naftës dhe gazit. Aktualisht, 25% e nxjerrjes së naftës në SHBA ndodh në këto territore, përfshirë 13% nga platformat në det.

Për më tepër, industria ka përfituar nga lehtësimet për gazsjellësit dhe naftësjellësit, të cilat janë bërë më të kollajta për t'u ndërtuar. Një tjetër masë e rëndësishme është tërheqja e rregullave të Komisionit të Letrave me Vlerë (SEC), që më parë kërkonin transparencë mbi ndikimin mjedisor të aktiviteteve të korporatave. Në epokën e re të Trump, këto detyrime janë eliminuar për kompanitë e naftës dhe gazit, duke reflektuar një kthesë të plotë në favor të industrisë së energjisë së prodhuar prej burimeve fosile. / Il Sole 24 Ore – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova sot synon fitore ndaj Letonisë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e vajzave e ka zhvilluar të hënën stërvitjen e fundit në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali për ndeshjen e radhës ndaj Letonisë në kuadër të Grupit 6 në Ligën C të Ligës së Kombeve. Kjo ndeshje zhvillohet sot (e martë) nga ora 14:00 në

stadiumin "Fadil Vokrri". Pas fitores bindëse ndaj Maqedonisë së Veriut (4:0), "dardanet" janë të motivuara për të vazhduar me rezultate pozitive dhe për një paraqitje tjetër të të njëjtit nivel. Gjatë seancës stërvitore ekipi ka punuar për përmirësimin e disa aspekteve taktike, me fokus eliminimin e

gabimeve të evidentuara në ndeshjen e kaluar. Përzgjedhësi Sami Sermaxhaj shprehu optimizëm për paraqitjen e ekipit, duke theksuar se skuadra ka bërë përgatitjet e duhura për këtë sfidë, por tha se rezultati është i paparashikuashëm, andaj edhe do të hyjnë në lojë me seriozitetin më të madh.

Futbollistet e Kosovës, po ashtu, shprehën besimin e tyre për këtë përballje, duke nënvizuar se e kanë analizuar mirë kundërshtarin dhe se me mbështetjen e tifozëve "dardanë", besojnë ta realizojnë fitoren e radhës. Kosova renditet e para në Grupin 6, me 3 pikë dhe synon ta vazhdojë ecurinë



pozitive në këtë kompeticion, me qëllim të realizimit të objektivit për rikthim në Ligën B.

Gjyqtari Bejtullahu: Bëra dy gabime të rënda, VAR-i nuk thirri për rishikim

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ndeshja e Superligës në mes të Dukagjinit dhe Gjilanit përfundoi me rezultat të barabartë 0-0. Pas kësaj ndeshjeje ankesa të mëdha pati skuadra mysafire që pretendoi se u dëmtua dy herë nga gjyqtari Mervan Bejtullahu, i cili nuk akordoi dy penallti. Një ditë pas kësaj ndeshjeje ka reaguar gjyqtari Bejtullahu, duke i pranuar gabimet e bëra në këtë ndeshje. "Pas një karriere të gjatë dhe të përkushtuar, mbi 17 vjet në Kosovë dhe vitet e fundit edhe në arenën evropiane, ku kam pasur privilegjin të gjykoj ndeshje të



rëndësishme, sot ndiej nevojën të bëj diçka që nuk e kam bërë kurrë më parë: të kërkoj falje publike. Analiza e thellë e videos nga ndeshja KF Dukagjini - SC Gjilani, e zhvilluar më 23 shkurt, ku unë

isha referi kryesor, kam zbuluar dy gabime të rënda. Në minutën e 15-të dhe në minutat shtesë, kam neglizhuar dy penallti të qarta dhe të padiskutueshme në favor të Gjilanit", ka thënë

Bejtullahu. Gjyqtari në fjalë ka bërë me dije se nuk është thirrur nga VAR-i për rikshikimin e këtyre rasteve. "Pavarësisht pamjeve të qarta dhe teknologjisë VAR, nuk jam thirrur për rishikim në asnjë prej këtyre rasteve. Jam plotësisht i bindur se, nëse do të më ishte dhënë mundësia të rishikoj pamjet, do të kisha akorduar të dyja penalltitë. Në rastin e pare nuk isha i bindur, ndërsa në të dytin pozicionimi im i largët për shkak të një kundërsulmi ndikoi në gjykimin tim. Megjithatë, kjo nuk e justifikon gabimin tim", ka shtuar ai.

Gjyqtari Mervan Bejtullahu i ka kërkuar falje skuadrës së Gjilanit dhe tifozëve "Skifterat". Ai është zotuar se këto gabime

do t'i marrë seriozisht dhe këto do t'i ndihmojnë që të përmirësohet për të ardhmen. "Kërkoj ndjesë të sinqertë ndaj klubit të SC Gjilanit, tifozëve 'Skifterave' dhe gjithë qytetit për këto gabime të paqëllimshme. Dhe në fund unë ende nuk e di arsyen se pse VAR-i nuk më ftoi dhe në të dyja rastet vendosi në favor të ekipit të KF Dukagjinit. Me sinqeritet të plotë, shpresoj që kjo ndjesë të shërbejë si një shenjë e pendesës sime të thellë. Unë i marr këto gabime shumë seriozisht dhe do të punoj vazhdimisht për të përmirësuar gjykimin tim dhe për të siguruar që standardet e arbitrimit të jenë sa më të larta në të ardhmen", ka deklaruar Bejtullahu.

'Ylli i javës', Kurtaj: Synojmë pjesën e epërme të tabelës

FERIZAJ, 24 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 21-të në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të FC Ferizaj, Albion Kurtaj. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Avni Shalës, Skënder Kaprës dhe Agim Maliqit. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e njëzet e një t'i

jepet Albion Kurtaj, i cili arriti që me golin e tij t'i sigurojë fitore shumë të rëndësishme ekipit të tij, FC Ferizaj, kundër FC Prishtinës (1:0), dhe t'i arkëtojë tri pikë që e larguan nga zona e rrezikshmërisë në Albi Mall Superligë. Pasi mori këtë çmim, Kurtaj u shpreh i lumtur që u vlerësua si më i miri i javës: "Ndeshja me Prishtinën ka qenë një ndeshje jashtëzakonisht e vështirë, duke marrë parasysh që Prishtina është një nga skuadrat më të mëdha në



Kosovë. Por, sidoqoftë, stafi i skuadrës sonë ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke e përgatitur ndeshjen në mënyrën më të mirë, dhe nga ajo nxorëm tri pikë për të cilat jam shumë i lumtur. Skuadra ka filluar të piqet dhe gabimet që i kemi bërë në sezonin e kaluar i kemi përmirësuar. Puna e trajnerëve është e jashtëzakonshme dhe kemi edhe një president që na rri shumë afër dhe nuk e ka humbur asnjëherë besimin te ne". "Synimet tona janë

gjithmonë të kërkojmë pjesën e epërme të tabelës dhe me këtë skuadër që kemi, besoj se mund ta arrijmë. Të shpallesh 'Ylli i javës' është një arritje shumë e madhe dhe e falënderoj gjithë stafin dhe skuadrën. Veçanërisht falënderoj familjen time që më ka përkrahur deri këtu. Shpresoj t'i ndihmoj skuadrës në vazhdimësi që t'i marrim të gjitha pikët që na nevojiten për të qenë në pjesën e sipërme të tabelës", ka deklaruar ai për faqen zyrtare të FFK-së.


KBF Bashkimi fiton Kupën e Kosovës

RAHOVEC, 24 SHKURT - Në një superfinalet në Rahovec, që ishte spektakël i basketbollit, prizrenaset fituan ndaj Prishtinës me rezultat 64:73 (14:21, 10:18, 25:12, 15:22). Ceremonia

zyrtare u hap me ndarjen e mirënjohjeve për vëzhguesen e ndeshjes dhe tre gjyqtarët e ndeshjes finale të Kupës së Kosovës, mirënjohje që u dhanë nga Valdet Spahija. Medaljet e

arta për KBF Bashkimi dhe ato të argjendta për KBF Prishtina u dhanë nga anëtarja e Bordit të FBK-së, Linda Shala dhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku. Shala ndau

edhe MVP-në e ndeshjes që i takoi Adrienne Godbold të Bashkimit. Trofeun e ndau kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe e pranoi kapitenia e KBF Bashkimit, Aulona Muhadri.



Andreeva triumfon në turneun Masters në Dubai, Rublev fiton në Doha

DUBAI, 24 SHKURT - Këtë fundjavë janë mbyllur disa nga turnetë e radhës për meshkuj e femra në tenis, ku nuk kanë mundur rezultatet surprizë. Në Doha (Katar) u zhvillua turneu ATP-500, ku triumfoi rusi Andrey Rublev. Në finale ai mundi 2-1 (7-5, 5-7, 6-1)

britanikun Jack Draper. Rusi rikthehet te suksesi pas 10 muajsh të vështirë në karrierën e tij. Në këtë turne morën pjesë edhe disa tenistë "big" si Carlos Alcaraz e Novak Djoković, por ata u eliminuan shumë herët. Kjo i jep mundësi Jannik Sinner ta mbrojë vendin e parë edhe

pse nuk luan, i pezulluar 3 muaj për doping. Për femra, tenistja 17-vjeçare ruse Mirra Andreeva fitoi turneun Masters-1000 të Dubai, suksesi i parë i madh në karrierë. Ajo bëhet tenistja më e re që fiton një turne kaq të rëndësishëm, duke shkruar historinë. Në

finale ajo mundi 2-0 (7-6, 6-1) Clara Tauson të Danimarkës. Një sukses i jashtëzakonshëm për një talente të re në këtë sport, që më herët pat eliminuar numrat 2 dhe 3 në botë, Iga Swiatek dhe Elena Rybakina. Falë këtij suksesi ajo ngjitet në vendin e 9 në botë.



Çeferin: As na ka shkuar në mendje ta luajmë finalen e Ligës së Kampionëve jashtë Evropës

NYON, 24 SHKURT - Aleksandër Çeferin ka dhënë një intervistë për median slovene "Delo", ku ka prekur disa tema të rëndësishme për futbollin evropian dhe atë botëror. Duke nisur me Ligën e Kampionëve, presidenti i UEFA-s e cilëson formatin e ri të garës si një sukses të madh: "Kam dëgjuar vetëm përgjigje pozitive. Fillimisht kishte kritika, si gjithmonë kur ndodhin ndryshime, por tani 99 % e njerëzve janë të kënaqur. Liga e Kampionëve është më e paparashikueshme se kurrë, askush nuk ishte i sigurt për kualifikimin në 1/8 finale deri në momentin e fundit". Çeferin mohon kategorikisht spekulimet për zhvendosjen e finales së Ligës së Kampionëve në një kontinent tjetër, jashtë Evropës: "Nuk kemi negociuar kurrë për ta luajtur finalen diku tjetër. Më surprizon që disa media të njohura publikojnë lajme të tilla pa kërkuar një koment nga UEFA. Nëse do të ishte e vërtetë, do ta dija". Në lidhje me raportimet për një



ofertë prej 1 miliard eurosh për Vinicius Junior, Çeferin shpreh skepticizëm: "E marr po aq seriozisht sa lajmet për finalen e Ligës së Kampionëve jashtë Evropës. Është një shifër e pabesueshme, që nuk ka bazë financiare, por nëse është e vërtetë, atëherë është vendimi i auditëve". Presidenti i UEFA-s ka vlerësim maksimal për Rodrin, fituesin e "Topit të Artë" 2024, duke theksuar se lojtari spanjoll është një nga më të mirët në botë por, ndoshta, nuk është aq i vërejtur sa sulmuesit: "Rodri ishte shpirti i Spanjës kampione të Evropës dhe i Manchester Cityt që ka fituar gjithçka. Nuk shënon shumë

gola dhe për këtë arsye nuk është aq i dukshëm për tifozët e zakonshëm, por ekspertët e vlerësojnë. Unë e mësova fituesin e 'Topit të Artë' vetëm në ditën e ceremonisë, pasi mbahet sekret deri në fund". Çeferin ka një marrëdhënie të shkëlqyer me Jose Mourinhon dhe vlerëson anën e tij humane: "Mourinho është një njeri i madh. Është unik në fushë, por jashtë saj është një person i mrekullueshëm. Gjatë pandemisë Covid-19 shpërndante personalisht ushqime për të moshuarit në Londër". Çeferin ka komentuar edhe transferimin e befasishtëm të Luka Donçiqit në NBA, duke bërë një krahasim me rregullat e futbollit: "Ishte një lëvizje tronditëse dhe, sipas mendimit tim, e padrejtë. Edhe nëse e dërguan te Los Angeles Lakersi, një klub më i madh, është e pabesueshme që ai nuk dinte asgjë për këtë. Kjo nuk mund të ndodhë në futboll. As një klub i vogël nuk mund të transferojë një lojtar pa pëlqimin e tij".

Clevelandi triumfon ndaj Memphisit, fitojnë Oklahoma, Warriorsi e Bostoni

OHIO, 24 SHKURT - Tjetër fitore në kampionat për Clevelandin, skuadër që udhëheq renditjen e NBA-s këtë sezon. Cavaliersi ka fituar me rezultat 129-123 ndaj Memphisit në fund të një ndeshjeje të ekuilibruar. Donovan Mitchell me 33 pikë dhe Evan Mobley me 25 pikë e 13 rebounde u dalluan për Clevelandin. Të njëjtin ritëm ndjek edhe skuadra e Oklahomës, që udhëheq në Perëndim. Ata fituan me shifrat 130-123 në fushën e Minnesotas, ku sërish protagonist ishte Alexander Shai, me 37 pikë. Fitoi Toronto, 127-109 ndaj Phoenixit, ndeshje ku Barrett, Quickley e Boucher realizuan nga 23 pikë



secili për kanadezët. Fitore edhe për Golden Staten, që falë 30 pikëve të Curryt, mundi Dallasin (126-106). Nuk zhgënjeu skuadra kampione e Bostonit, që triumfoi me rezultat 118-105 ndaj New

REZULTATET	
Boston - New York	118-105
Golden State - Dallas	126-102
Indiana - Clippers	129-111
Atlanta - Detroit	143-148
Milwaukee - Miami	120-113
Orlando - Washington	110-90
Toronto - Phoenix	127-109
Cleveland - Memphis	129-123
New Orleans - San Antonio	114-96
Minnesota - Oklahoma	123-130

Yorkut, takim ku dyshja Tatum - Brown realizuan 49 pikë së bashku. Skuadra e Milwaukeees, falë 28 pikëve të Lillardit e 23 të Antetokounmpos, mundi me rezultat 120-113 Miamin.

SHKURT

Lajm jo i mirë për Shqipërinë, lëndohet Gjimshiti

Berat Gjimshiti ishte protagonist në fitoren 5-0 të Atalantës në transfertën e Empolit. Kapiteni i Shqipërisë ishte i pakalueshëm në mbrojtje, por edhe asistoi në golin e dytë të shënuar nga Retegui. Megjithatë në fund të pjesës së parë ai pësoi një dëmtim, i cili fillimisht u duk i lehtë, pasi kapiteni kuqezi u rikthye në fushë në pjesën e dytë. Por në minutën e 63-të trajneri Gasperini e largoi nga fusha, pasi Gjimshiti nuk mund të vazhdonte më tej. Ky duket një ogur i keq, pasi në rast dëmtimi ai do të mungonte në ndeshjet kualifikuese për kampionatin botëror që Shqipëria do të luajë në muajin mars.

Qazim Laçi, pjesë e formacionit të javës në Çeki

Fundjava rezultoi fantastike për Qazim Laçin, i cili, edhe pse në rolin e mesfushorit, ka një marrëdhënie të mirë me golin. Laçi gjeti rrugën e rrjetës me fanellën e Spartës së Pragës në duelin ndaj Ceske Budejovice të vendit të fundit. Laçi zhbllkoi sfidën në minutën e 64-t ku, pas asistimit të Panak, goditi saktë në hyrje të zonës, duke përshëndetur rrjetën. Ky gol i dhuroi avantazhin Spartës së Pragës, që 11 minuta më vonë shënoi edhe të dytin me Zelenin. Ky ishte goli i dytë në kampionat për Qazim Laçin, i cili është aktivizuar 19 ndeshje si dhe ka regjistruar edhe tri asistime. Një episod tjetër gjatë kësaj ndeshjeje ishte po me futbollistin e Kombëtares. Në minutën e 83-të Laçi realizoi edhe golin e dytë personal, por që më pas u anulua nga VAR-i për faull ndaj portierit kundërshtar, i cili për një çast humbi edhe ndjenjat në fushë, pas përplasjes me futbollistin Kuçta. Falë kësaj paraqitjeje mesfushori kuqezi është përfshirë në formacionin e javës në Ligën e Parë të Çekisë, me notën më të lartë 9.2.

Slot: Titulli? Në Premierë Ligë asgjë nuk është e sigurt

Trajneri i Liverpoolit, Arne Slot, pavarësisht prej fitores 2-0 ndaj Manchester Cityt dhe shkëputjes 11 pikë ndaj Arsenalit në renditjen e Premierë Ligës, deklaroi se asgjë nuk është e sigurt. Sipas tij, në një kampionat të tillë gjithçka mund të ndodhë. "Tifozët mund të këndojnë çfarë të duan, por ne si ekip e dimë se sa shumë duhet të punojmë për çdo fitore. Tri ditë më parë dikush më pyeti nëse patëm një rënie pas barazimit me Aston Villan. Tani jam pak më i qetë pas fitores ndaj Cityt. Është kaq e vështirë ta gjykojmë tabelën e renditjes në Premierë përpara se të luhet çdo ndeshje. Në çdo ligë tjetër të kesh një epërsi si kjo do të ishte shumë komode, ndërsa këtu edhe brenda një ndeshjeje të vetme ke shumë sfida", ka thënë Slot. "Do të jem më i qetë kur të ketë kaluar edhe pak kohë. Kemi edhe Ligën e Kampionëve, ndaj duhet kujdes për të mos nënvlerësuar asgjë. Duhet përqendrim, ndaj e konsideroj ende të gjatë rrugën deri në fund", ka shtuar Slot.

Kompany: E rëndësishme ta ruajmë distancën me rivalët

Fitorja 4-0 ndaj Eintracht Frankfurtit e ka mbajtur në 8 pikë avantazhin mes Bayern Munchenit dhe rivalëve të tjerë. Një ndeshje perfekte e bavarezëve, që edhe pse me disa mungesa arritën të

triumfojnë ndaj vendit të tretë në Bundesliga. "Ne luajmë shumë mirë, patëm shanset tona dhe i shfrytëzuam ato. Kemi qëndruar gjithmonë të qetë dhe të tillë jemi edhe tani.

Dita shtesë na ndihmoi për t'u stërvitur dhe kjo u pa në fushë, te ky rezultat", ka thënë Vincent Company. Më tej, trajneri i bavarezëve ka shtuar: "Është jetike për ne që të marrim sa më shumë

rezultate pozitive, për ta ruajtur diferencën ndaj rivalëve. Përpjekja, entuziazmi, dëshira për fitore ishin të gjitha aty në këtë ndeshje". "Është e qartë se një fitore në këtë mënyrë është

shumë më argëtuese. Qëllimi ynë është gjithmonë të luajmë për fitore. Ky sukses na jep mundësi që ta kalojmë me qetësi këtë periudhë deri në ndeshjen e radhës", ka deklaruar Company.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
